

**RAPORTI I SHQYRTIMIT PUBLIK PËR PLANIN
ZHVILLIMOR KOMUNAL TË KOMUNËS SË
FUSHË KOSOVËS 2025 – 2033**



PËRMBAJTJA

1.	TË DHËNA TË PËRGJITHSHME	3
2.	QËLLIMI I RAPORTIT	3
3.	AKTIVITETET GJATË SHQYRTIMIT PUBLIK	4
3.1.	NJOFTIMI PËR HAPJEN E SHQYRTIMIT PUBLIK.....	4
3.2.	VENDIMI PËR HAPJËN E SHQYRTIMIT PUBLIK.....	5
4.	PJESËMARRËSIT	6
5.	PJESA HARTOGRAFIKE SI DHE LIBRI I KOMENTEVE, PROPOZIMEVE, VËREJTJEVE DHE SUGJERIMEVE NE HOLLIN E OBJEKTIT TË KOMUNËS SË FUSHË KOSOVËS.....	9
6.	KOMENTET E PRANUARA GJATË FAZËS SË SHQYRTIMIT PUBLIK - (TË SKANUARA):	10
7.	VENDIMI PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR SHQYRTIMIN E KOMENTEVE, PROPOZIMEVE, VËREJTJEVE SI DHE SUGJERIMEVE	27
8.	KOMENTET E PRANUARA DHE TRAJTIMI I TYRE.....	29
9.	NDRYSHIMET E BËRA NË PROJEKT PLANIN ZHVILLIMOR KOMUNAL TË FUSHË KOSOVËS 2025 - 2033	35
11.	KONKLUZIONE	35
12.	PËRFUNDIM	36



RAPORTI I SHQYRTIMIT PUBLIK PËR PLANIN ZHVILLIMOR KOMUNAL (PZHK) 2025 – 2033
TË KOMUNËS SË FUSHË KOSOVËS

1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

- **Emri i Dokumentit:**

Plani Zhvillimor Komunal 2025 – 2033

- **Komuna:**

Komuna e Fushë Kosovës

- **Periudha e shqyrtimit publik:**

04.08.2025 – 04.09.2025 (30 ditë)

- **Procesi i udhëhequr nga:**

Drejtoria për Planifikim Urban

2. QËLLIMI I RAPORTIT

Ky raport është përpiluar për të dokumentuar të gjitha aktivitetet e ndërmarra gjatë fazës së Shqyrtimit Publik të Draftit të Planit Zhvillimor Komunal, si dhe për të paraqitur të gjitha komentet e pranuar dhe mënyrën e trajtimit të tyre nga komuna, në përputhje me U.A. 11/2015.

3.1. NJOFTIMI PËR HAPJEN E SHQYRTIMIT PUBLIK



Republika e Kosovës

Komuna Fushë Kosovë



SQ ▾

Kërko...

Si mund të ?

Ballina

Komuna ▾

Kuvendi ▾

Drejtoritë ▾

Qyteti

Investimet

Shpalljet

Prokurimi

Njoftim dhe Ftesë për: Shqyrtim publik të PZHK – Plani Zhvillimor Komunal “Fushë-Kosova 2025-2033”



Njoftim dhe Ftesë për: Shqyrtim publik të PZHK – Plani Zhvillimor Komunal “Fushë-Kosova 2025-2033”

28/07/2025

Komuna e Fushë-Kosovës

Jul 29 •

- Në web-faqen zyrtare të Komunës
- Në hollën e objektit të Komunës
- Në zyrat e Drejtorisë për Planifikim Urban

Komentet mund të dorëzohen:

- Fizikisht në Drejtorinë e Planifikimit Urban
- Në formën elektronike nëpërmjet formularit online në web-faqen e Komunës
- Përmes email-it: parayll.zogjani@rks-gov.net

Për më shumë informata:
Drejtoria për Planifikim Urban

Tel.: 038 200 40 527

Email: parayll.zogjani@rks-gov.net

Bëhuni pjesë e vendimmarrjes për të ardhmen urbane të Fushë-Kosovës!

me në Ligjin për Planifikimin Hapësinor No.04/L-174, UA No.11/2015 në të cilin elementet në themelues për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunalit të 2014 për përgjithësimin e autoritetit të Planifikimit Hapësinor si dhe parimet dhe skemat për përfshirjen e publikut në planifikim hapësinor, Komuna e Fushë-Kosovës si dhe Rrethi në

Drejtoria e Planifikimit Urban

SHQYRTIM PUBLIK TË PZHK

Planin Zhvillimor Komunal "FUSHË-KOSOVË 2025-2033"

si 04.08.2023 datë 04.09.2023

R: Objekti i Komunitetit në Fushë-Kosovë (Rrethi i Komunitetit) dhe zyeret e tij të bashkëpunimit me Drejtorinë e tjerë komunale, grupet punuese dhe komitetet konsultive "INSI" SH.P.K.

komuna e Fushë-Kosovës ka hartuar **Planin Zhvillimor Komunal 2025-2033**, ku si bëri pjesë drejtues Komuna e Fushë-Kosovës për zbatimin dhe monitorimin e Planit në bashkëpunim me Drejtorinë e tjerë komunale, grupet punuese dhe komitetet konsultive "INSI" SH.P.K.

landshirimit e dokumentit, parapëlqesiv ligjit, ku draft-dokument shpallur rreth publik për 30 ditë për qytetarëve dhe të gjitha palët të tjera të komunitetit që prekën nga zhvillimi i qytetit në tërësi (R) vjetër e ardhshme.

a zyre e shqyrtimit publik me pjesën teknike dhe grafike dhe prezantim të "Planit zhvillimor Komunal të Komunitetit në Fushë-Kosovë" për vitet 2025 dhe të bëhet në shtetë e Kuvendit të Komunitetit me **datë 04.08.2023 në ora 09:00**.

nuna zbatet e përkushtuar të bashkëpunimit ngushtë me të gjitha palët e zyre që janë të gatshet të kontribojnë në përgatitjen e një dokumenti të mirëmbledh të lehtë të zbatueshëm, prandaj ju ftojme të jeni pjesë e kësaj rrethi dhe diskutimi publik, ku gjuetmarrja dhe kontributi juaj do të mundë landshirimit të gjithë ndihmë dritë të përmirësimit të tjerë dhe krijë

Faqe 2 nga 2

Komuna e Fushë-Kosovës, Drejtoria për Urban
Adresa: Vllazur, "Tahir Dine", Nr. 1, 10000, Fushë-Kosovë (R. e Kosovës)
Telefon: 038 200 40 527, parayll.zogjani@rks-gov.net

ndëshive të reja në komunën tuaj.

tyrtim publik do të zgjas 30 ditë nga data 04.08.2023 deri 04.09.2023. si të interpretuar mund të japin komente, propozime, sugjerime ose vërejtje do të shqyrtohen me profesionalizëm dhe me korrektësi të plotë nga anëtarët punues në bashkëpunim me kompanitë konsultive "INSI" SH.P.K.

mentit i PZHK: në do të jetë i qasueshëm në:

-faqen zyrtare të Komunitetit në Fushë-Kosovë;

-i objektit të Komunitetit në katën përfaqësive;

-e Drejtorisë së Planifikimit Urban në Fushë-Kosovë.

ment mund të dorëzohen në mënyrë fizike në Drejtorinë e Planifikimit Urban apo edhe përmes formës elektronike në ligkun e PZHK, në web-faqen tonë ose përmes email-it: parayll.zogjani@rks-gov.net

ni shërbet informata, ju lutem kontaktoni në Drejtorinë e Planifikimit Urban në Fushë-Kosovë:

Telefon: 03820040527

E-mail: parayll.zogjani@rks-gov.net

Sori i DPJ: Parayll Zogjani

Kryetari i Komunitetit (Burim Berisha)

Faqe 2 nga 2

Komuna e Fushë-Kosovës, Drejtoria për Urban
Adresa: Vllazur, "Tahir Dine", Nr. 1, 10000, Fushë-Kosovë (R. e Kosovës)
Telefon: 038 200 40 527, parayll.zogjani@rks-gov.net

3.2. VENDIMI PËR HAPJËN E SHQYRTIMIT PUBLIK



Bazuar në Ligjin për Planifikimin Hapësinor Nr.04/L-174, UA Nr.11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe UA Nr.05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, Komuna e Fushë-Kosovës ju njofton dhe fton në :

SHQYRTIM PUBLIK TË PZHK

Për : **Planin Zhvillimor Komunal "FUSHË KOSOVA 2025-2033"**

Datë : 04.08.2025 deri më 04.09.2025

Vendi : Objekti i Komunës së Fushë Kosovës-(Holl i Komunës) dhe zyret e Drejtorisë së Planifikimit Urban.

-Komuna e Fushë-Kosovës ka hartuar **Planin Zhvillimor 2025-2033**, ku si bartëse e këtij procesi është Komuna e Fushë-Kosovës përkatësisht Drejtoria e Planifikimit Urban në bashkëpunim me Drejtorinë e tjera komunale, grupet punuese dhe kompaninë konsulente **"INSI" SH.P.K** me seli në Prishtinë.

Për finalizimin e dokumentit, para aprovimit final, ky draft-dokument shpallet në shqyrtim publik për **30 ditë** para qytetarëve dhe të gjitha palëve të tjera të interesuara që preken nga zhvillimi i qytetit në tetë (8) vitet e ardhshme.

Hapja zyrtare e shqyrtimit publik me pjesën tekstuale dhe grafike dhe prezantimi i "Projekt -Planit zhvillimor Komunal të Komunës së Fushë Kosovës për vitet 2025-2033 do të bëhet në sallën e Kuvendit të Komunës me **dt:04.08.2025 në ora 09:00**.

-Komuna është e përkushtuar të bashkëpunojë ngushtë me të gjitha palët e interesuara që janë të gatshëm të kontribojnë në përgatitjen e një dokumenti të qëndrueshëm dhe lehtë të zbatueshëm, prandaj ju ftojmë të jeni pjesë e këtij shqyrtimi dhe diskutimi publik, ku pjesëmarrja dhe kontributi juaj do të mundësojë një planifikim të mirëfillt duke ndikuar direkt në përmirsimin e jetës dhe krijimin

Faqe 1 nga 2

Komuna e Fushë-Kosovës, Drejtoria për Arsim
Adresa : Rruga : "Tahir Zema", Nr : 2, 12000, Fushë Kosovë-R.e.Kosovës
Telefon: 038/ 200 40 528 , <http://nk.rks-gov.net/fushëkosovë>

e mundësive të reja në komunën tonë.

-Shqyrtimi publik do të zgjas **30 ditë nga data 04.08.2025 deri 04.09.2025**, ku të gjithë të interesuarit mund të japin komente, propozime, sugjerime ose vërejtje, të cilat do të shqyrtohen me profesionalizëm dhe me korrektësi të plotë nga anëtarët e grupit punues në bashkëpunim me kompaninë konsulente **"INSI" SH.P.K.**

Dokumenti i PZHK-së do të jetë i qasshëm në :

- web-faqen zyrtare të Komunës së Fushë Kosovës.

-Holl i objektit të Komunës në katin përdhës.

-zyret e Drejtorisë së Planifikimit Urban në Fushë Kosovë.

-Komentet mund të dorëzohen në mënyrë fizike në Drejtorinë e Planifikimit Urban apo edhe përmes formës elektronike në linkun e PZHK në web-faqen e Komunës ose përmes email-it: parayll.zogjani@rks-gov.net

Për më shumë informata, ju lutem kontaktoni në Drejtorinë e Planifikimit Urban të Komunes se Fushe Kosoves
nr.tel: 03820040527 ose
email: parayll.zogjani@rks-gov.net

Drejtori i DPU: Parayll Zogjani



Kryetari i Komunës : Burim Berisha




Faqe 2 nga 2

Komuna e Fushë-Kosovës, Drejtoria për Arsim
Adresa : Rruga : "Tahir Zema", Nr : 2, 12000, Fushë Kosovë-R.e.Kosovës
Telefon: 038/ 200 40 528 , <http://nk.rks-gov.net/fushëkosovë>

4. PJESËMARRËSIT


- Lista e pjesëmarrësve në takime me emër, mbiemër, përfaqësim dhe nënshkrim (si aneks).

Nr.	Emir dhe Mbiemri	Email /Nr.tel	Nënshkrimi
1	PARAYLL ZOGRIAN	049 569 847	
2	Raimon Zogriani	049 569 847	
3	VJOSTA RANA	045 309 093	
4	Besnik Hykazi	044 875 023	
5	ADRIAN BULLTAVIC	044 684 626	
6	Oljga Ferdi Morshini	045 1270 - 317	
7	Ismet Istogaj	044-308-259	
8	SYLE IDRIZAJ	044 567 183	
9			
10			
11			
12			
13			
14			


- **Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve:**

8 qytetarë.

- Foto nga Hapja e Shqyrtimit Publik për Projekt Planin Zhvillimor Komunal të Fushë Kosovës 2025 - 2033



5. PJESA HARTOGRAFIKE SI DHE LIBRI I KOMENTEVE, PROPOZIMEVE, VËREJTJEVE DHE SUGJERIMEVE NE HOLLIN E OBJEKTIT TË KOMUNËS SË FUSHË KOSOVËS



6. KOMENTET E PRANUARA GJATË FAZËS SË SHQYRTIMIT PUBLIK - (TË SKANUARA):

LIBRI I KOMENTEVE, PROPOZIMEVE, SUGJERIMEVE OSE VËREJTJEVE TË QYTETARËVE GJATË SHQYRTIMIT PUBLIK TË
PROJEKT PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL I FUSHË KOSOVËS 2025 - 2033



Emri dhe Mbiemri:

ALBION SHALA

Data:

12.08.2025

KOMENT, PROPOZIM, SUGJERIM OSE VËREJTJE:

Kërkoj nga Komuna e Fushë Kosovës të bëjë ndryshimin
e destinimit për zonë në të cilën gjendet parcela
me Shtetë e Madhe rretho për Aterport parcela me
nr. 01018-1 nga zonë bujqësive në zonë komerciale

Shprehës në mirëkuptimin tuaj, dhe shprehës që
kërkesa ime të aprovohet.

Nr. tel. 049 111 994





Emri dhe Mbiemri:

REXHEP HAJDARI

Data:


14.08.2025

KOMENT, PROPOZIM, SUGJERIM OSE VËREJTJE:

I DREJTOHEM KUVENDI KOMUNA TË F. KOSOVËS
QË NË HORTAT E REJA ZONË TË KEN
PARASYSH QË PARCELAT 785-3 dhe 785-4
TË HYN NË PLAN PËR NDËRTIM TË LARTË

SIPO S PARTËS SË PLANIT ZHVILLIMOR KËTO
DY PARCELA (RR. ABIZ ZHILIVODA), BANIM I PËRHERËS
ANDË DU ZUSËM TË KËNI PARASYSHË
KËRKESËN TON QË KË ZONË TË HYJË
NË NDËRTIM TË LARTË

SHËRËSOJ NË MIKURTIM, NË RASTË SË
KËNI NGUOJE PËR NDONË SADRIM
KY ËSHË TEL IM 049 126 988





Emri dhe Mbiemri:

SABIT BERJANI


Data:

26.08.2025

KOMENT, PROPOZIM, SUGJERIM OSE VËREJTJE:

KËRKOJMË NGA DREJTORIA E URBANIZMIT
QË PARCELËN ME NUMËR 264-0 TA PËRSHIHET
NË ZONË NDËRTIMORE E DOASHTU SË BASHKU
ME PARCELAT 265 DHE 266; ⁴²⁰ TË NDËRROHET
DESTINIMI NGA BANIM NË BIZNES.

QJITHASHTU PARCELAT NË MIRADI TË EDGËRME
ME NR. PARC. 444-0; 93-0, 104-0 DHE 124-48; 6
TË PËRSHIHEN NË ZONA NDËRTIMI PËR ARSYE
SE AFËR KËTYRE PARCELAVE KA NDËRTIME
TË SHTËRIVE DHE BIZNESË. PRANDAJ
KËRKOJ QË EDHE KËTO PARCELA TË
PËRSHIHEN NË HARTËN E RE ZONALE
SIKURSE ZONAT QË JANË AFËR TYRE.
Nr. Kontaktes: 044-425-157





Emri dhe Mbiemri:

HASIM RASHICA

Data:

28.08.2025

KOMENT, PROPOZIM, SUGJERIM OSE VËREJTJE:

- LIDHUR ME DISKUTIMIN PUBLIK PËR PZH
FUSHË KOSOVA 2025-2033, KËRKOJMË QË TE HARTA
E SHFRYTËZIMIT TË PLANIFIKUAR TË TOKËS
TË RREGULLOHET DESTINIMI PËR PARCELËN ME
NR. 00040-0 NË ZK. POMOZOTIN.
KËTË KOMENT-KËRKESË-VËREJTJE-SUGJERIM
- PËRMES KËTIJ LIBRI, E JAPIM ME SHPRESËN
QË TË MERRET PARASYSHË.
KJO PARCELË TË DESTINOHET PËR BANIM/
BANIM TJETËR - JO I PËRHERSHËM POR QË
KA MUMËSI TË PLANIFIKOHET SI ZONË NDËRTIM,
- KY LOKACION KA TË GJITHA PARAKUSHTET
DHE INFRASTRUKTURËN E NEVOJSHME QË TË
SHFRYTËZOHET SI I TILLË - BANIM JO I PËRHERSHËM.
- PËR SQARIME SHITESË MËSE KA NEVOJË. 044399896
FAZEMINDERIT PËR MIRËKUPITIMIN TUAR. Me respekt.

Hasim Rashica





Emri dhe Mbiemri:

RAMADAN RASHICA, MUHAMET RASHICA
GANI RASHICA

Data:

28.08.2025

KOMENT, PROPOZIM, SUGJERIM OSE VËREJTJE:

KËRKOJMË QË TEK PARCELA ME NR. 00040-0 NË ZK.
POMOZOTIN, TË DESTINOHET PËR PLANIFIKIM BANIM
BANIM TJETËR.


NE JEMI BASHKËPRONAR TË KESAJ PARCELE.
KJO TË DESTINOHET PËR SHFRYTËZIM TË LEJIMIT
TË NDËRTIMIT PËR OBJEKTE TË VOGLA POR HE
KARAKTER TË BANIMIT JO TË PËRHERSHËM.

KËRKOJMË TE HARTA E SHFRYTËZIMIT TË PLANIFIKUAR TË TOKËS
TE BEHET KY PREGULLIM.

FALËMINDERIT PËR MIREKUPITIM,

Me respekt,

Nr. tel. 044157152





Emri dhe Mbiemri:


ARIF SHABANI

Data:

28.08.2025

KOMENT, PROPOZIM, SUGJERIM OSE VËREJTJE:

KËRKOJ QË PARCELA 00857-1 ZK-
SHLATINË QADHË TË DESTINOHET NË
ZONË INDUSTRIALE SIKUR PARCELAT
TJERA APOË HËKURUDHËS. QË JANË
DESTINONË ZONË INDUSTRIALE
PARCELA KA DALJË NË PRUGËN PËR MAGURË
DITË QASTË NË HËKURUD
KËRKOJ HIRËKUPITIMIN TUAJ
FALSHINDORIT
044-861172





Emri dhe Mbiemri:

Hasan Osmani

Data:

09/09/2025

KOMENT, PROPOZIM, SUGJERIM OSE VËREJTJE:

Kerkoj nga drejtoria per planifikim Urban qe

Zonen kadastrale ne Ponoratin kontraktist parcelen

00361-5 dhe parcellet tjera perrehta te kane

mundesire e nditimit te ulket dhe te parkoshem.


Une dhe pronaret e keraj lloje ne numra te parcelave

361-1,2,3,...30, kerkojne qe te planifikohet dhe

te na lejohet ne PZHK 2025-2033 shfrytëzimi

i keraj pjese te tokes per banim te parkoshem

Faleminderit





Emri dhe Mbiemri:


MUHAMET GËRGURI

Data:

02.09.2025

KOMENT, PROPOZIM, SUGJERIM OSE VËREJTJE:

KERKES QE PARCELA 451-0
DHE 426-5 ZK SLLATIN E VOGEL
TE TRAJTOHET NE ZONE INDUSTRIALE
SIKUR PARCELAT NE FQINJESI
DHE PARCELAT 430-1, 430-2-430-4
288-1, 288-2, ZK SLLATIN E VOGEL
TE KEN DESTINIM TE PERZIER
BANIM - AFARIZEM SIKUR PARCELA
NE FQINJESI,





Emri dhe Mbiemri:

MERGIM PRISHTINA - TREPHARM

Data:

04.09.2025

KOMENT, PROPOZIM, SUGJERIM OSE VËREJTJE:


KËRKOJMË NGA KUVENDI KOMUNAL I F.KOSOVËS
ECILA NË PLANIN ZHVILLIMOR-KOMUNAL TË KOMUNES
FUSHË KOSOVË 2025-2033, PARCELËN ME NR.00665-6
NË SUATINË TË MADHE, NGA DESTINIMI I CILI
SIPAS PLANIT KOMUNA ZHVIL. ËSHTË PARAPAR TË
JETË : PRODHIM PARSOR / PYLTARI I BAZUAR NË
MBULES TË VAZHDIESHME.

KËRKOJMË :

PËR ARSYE TË ZGJERIMIT TË KAPACITETEVE
PRODHESE, OBJEKTEVE PËRCJELËSE ME INVESTIT.
OK GJERMAN, KËRKOJMË TË NDRYSHOHET
DESTINIMI NË :

PRODHI TRETËSOR / INDUSTRIE PRODHEVE TË
LEHTA / PRODHIM I PIJEVE, USHQIMEVE DHE
PRODUKTEVE TË DUHATIT.

ME RESPEKT : MERGIM PRISHTINA
"TREPHARM"





Emri dhe Mbiemri:


AL TRADE CENTER SH.P.K

Data:

04.09.2025

KOMENT, PROPOZIM, SUGJERIM OSE VËREJTJE:

KERKOS QË PARCELAT ME NR: 02022-0, 02017-4
02017-5, 02018-2, 02011-1, 02012-1, 02007-4
02008-1, 02003-2, 01641-5, 01641-4, 01648-0
ZK F.KOSOVË TË DESTINOHEJN SI ZONË KOHERCIALE
OSE ZONË PËR SHPRITËZIM TË PERZIER DUKE
KRIJUAR NË KËTË FORM ZHVILLIM TË VAZHDOUESHËM
ME ZONAT PËRRETH SEPSE KONSIDEROJM SË NË
KËTË FORM PËRJASHTOHEMI PATË DREJTË MGA
ZHVILLIMET E MUNDSHME PËR PËRIVOHEN 10 VJECARE,
VLERSOJM SE KA MJAFTUSHËM ARGUMENTE QË
KJO ZONË TË MOS MBETET ZON BUIQSORE
ANDAZ MBESIM ME SHPRES SE KERKESA JONË DO TË
MËRRET PARASYSH.





Emri dhe Mbiemri:


PERFADËSUES I FSHATIT SLLATINË

Data:

02.09.2025

KOMENT, PROPOZIM, SUGJERIM OSE VËREJTJE:

KËRKON NGA KOMUNA QË MARCËLA 01065-0
TË JET ZONË EMRATOR PAS NË TË
KËNË QËN ORUM GJATË LUFTOS
DITË DSHTË VORRËI HSUSIT KADRI.





Emri dhe Mbiemri:

AGIM SHISHANI

Data:

04.09.2025

KOMENT, PROPOZIM, SUGJERIM OSE VËREJTJE:

Kërkoj që parcela 00848-0 ZKA shkatërrim
të ndërrohet në zonë industriale
si të afër hekurudhës.
siparshelot që janë bërë.





Emri dhe Mbiemri:


HASHIM SHABANI

Data:

04.09.2025

KOMENT, PROPOZIM, SUGJERIM OSE VËREJTJE:

Kerkoj nga K.K.F.K për parcelat 00847-1
zone katërkëndëshe të shërbimit të shëndetësisë
në zonë industriale.





Emri dhe Mbiemri:

ERKON SHABANI

Data:

04.09.2025

KOMENT, PROPOZIM, SUGJERIM OSE VËREJTJE:

NË PARCËLON 14-1 ZK. SLLATINIS SHADO
KA PËRMISHË ËSHTO ÇËSHITJA SHKATËRIT
ANË KËRKON QË TË JET SIË KË QËND
ZONE BUDQËSORË.





Emri dhe Mbiemri:


EKREM SHABANI

Data:

04.04.2025

KOMENT, PROPOZIM, SUGJERIM OSE VËREJTJE:

KËRKOJM QË PARCEL 00265-0,
00267-0 dhe 00226-8 TË MOS KALOJN
NË ZONË RANIM. SË JANË PRONA TË
FSHATIT SLLATINË EMADHO
PARCELA 00226-8 ËSHTË PRONË E SHABANOVIUS
MOSTË BËHËN MATHEMATIKA MË PRONA.
QË QË 25 VJET PASË NË SHTOPI
NUK ËSHTË NDËRTU NË KËTO PJES.
MOS BOLI LLOGARI PËR INTERESA
TË JUAT.





Emri dhe Mbiemri:

Fatmir Vërbos


Data:

04.09.2025

KOMENT, PROPOZIM, SUGJERIM OSE VËREJTJE:

KËRKOJM QË SIPAS PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL
QË ËSHTË NË DISKUTIM PUBLIK TË PLANIFIKOHET
NË ZONEN KATASTRALE POMOROTIN PARCELA ME
NUMER 0042-22 TË DISKUTOHET PËR BANIM-TËTËR
E CILA DO TË KETË BANIM TË PËRKONSHËM
INFRASTRUKTURË ËSHTË E KOMPLETUAR PËR KËTË
ZONËN (RREGË, ENERGJI ELEKTRIKE, UJËSHELLËS, DHE
KANALIZIM) DHE KA KUSHTE TË MJATTMËSHME PËR
NDËRTIM ME KARAKTER TË PËRKONSHËM.

045 M2 M3





Emri dhe Mbiemri:

ROSNIK JASHANICA

Data:


04.09.2025

KOMENT, PROPOZIM, SUGJERIM OSE VËREJTJE:

KËRKOJ QË PARCELA 00971-5 ZKA SKLATINE
TË BSHAT ZONË INDUSTRIALE
NGA Toka BUDOZORJ.



7. VENDIMI PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR SHQYRTIMIN E KOMENTEVE, PROPOZIMEVE, VËREJTJEVE SI DHE SUGJERIMEVE





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

Më datë: 27.02.2023

Zyra e Kryetarit, pas shqyrtimit të propozimit 05, nr. 04/L-174 të datës 23.02.2023, paraqitur nga Drejtorati për Planifikim Urban sipas Ligjit nr. 04/L-174, Për Planifikim Hapësinor, (GZ nr.30 dt 23.08.2013), UA i MMPHI nr.11/2015, Mbi elementet dhe kërkesat themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal, si dhe Kontratës me titull "Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal" nr.612-22-11782-2-2-1/C435m, të dt. 10.02.2023 të Drejtorisë për Planifikim Urban, Zyra e Kryetarit mori këtë:

V E N D I M

Formimi i Ekipit Komunal për Planifikim në përbërje:

1. Abdullah Prebreza, Drejtorja për Urbanizëm
2. Parayll Zogjani, Drejtorja për Planifikim Urban
3. Donart Zharku, Drejtorja e Inspeccionit
4. Ardit Sekiraqa, Drejtorja për Infrastrukturë
5. Antigona Sahiti, Drejtorja për Planifikim Urban
6. Fatime Ismajli, Drejtorja për Planifikim Urban
7. Besnik Hykolli, Drejtorja për Planifikim Urban
8. Mobere Hyseni, Drejtorja për Planifikim Urban
9. Adnan Bullatovci, Drejtorja për Planifikim Urban
10. Mimoza Kolshi, Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale
11. Samire Gërguri, Drejtorja e Inspeccionit
12. Samir Rashica, IT

13. Jehona Gërguri, Drejtoria e Inspektionit
14. Hasan Gjyrevci, Zyra Ligjore
15. Merita Krasniqi, Drejtoria për Buxhet dhe Financa
16. Nexhat Bajqinca, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencës
17. Vlora Berjani, Drejtoria për Arsim
18. Adelina Gashi, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
19. Ejup Qyqalla, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencës
20. Milanka Bojkoviq, Zyrtare për Ekonomi dhe Financa
21. Bashkim Krasniqi, Këshilltar Komunal

Arsyetim

Drejtorati për Planifikim Urban sipas Ligjit nr. 04/L-174 Për Planifikim Hapësinor (GZ nr.30 dt 23.08.2013), UA i MMPHI nr.11/2015 Mbi elementet dhe kërkesat themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal si dhe Kontratës me titull "Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal" nr.612-22-11782-2-2-1/C435 të dt. 10.02.2023 të Drejtorisë për Planifikim Urban ka bërë propozim për formimin e grupit punues.

Pas shqyrtimit të propozimit në fjalë nga Zyra e Kryetarit, ka vërtetuar se lista e zyrtarëve për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, është i përbër nga kategorit përgjegjëse të zyrtarëve publik, andaj edhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Akti i dorëzohet:

- 1x Kryetarit të Komunës
- 1x Drejtorisë për Planifikim Urban
- 1x Arkivës



8. KOMENTET E PRANUARA DHE TRAJTIMI I TYRE

Nr.	Nga:	Data:	Komenti:	Trajtimi i komentit:
1	Albion Shala	12.08.2025	Kërkoj nga komuna e Fushë Kosovës të bëjë ndërrimin e destinimit për zonë në të cilën gjendet parcela ime në Sllatinë e Madhe, rruga për Airoport, parcela me nr. 01018-1 nga zona bujqësore në zonë komerciale.	Kjo kërkesë është trajtuar dhe adresuar gjatë fazës së hartimit të dokumentit të PZhK-së dhe gjatë diskutimeve të mëhershme publike me qytetarët. Duke parë rëndësinë dhe nevojën e zhvillimit të zonës përreth rrugës së Aeroportit, shiriti përgjatë kësaj rruge është planifikuar si zonë komerciale. Për rrjedhojë, parcela në fjalë tashmë është e përfshirë në kuadër të destinimit komercial në projekt-planin zhvillimor komunal, dhe nuk paraqet ndryshim të ri pas shqyrtimit publik.
2	Rexhep Hajdari	14.08.2025	I drejtohem Kuvendit Komunal të Fushës Kosovës që në hartat e reja zonale të ken parasysht që parcelat 785-3 dhe 785-4 të hyn në plan për ndërtim të lartë. Sipas hartës së planit zhvillimor këto dy parcela (Rr. Aziz Zhilivoda), banim i përhershëm, andaj ju lusim të keni parasyshtë kërkesën tonë që kjo zonë të hyjë në ndërtim të lartë.	Me kete nivel te planifikimit (pra me PZHK) kërkesa juaj nuk mund të aprovohet duke marre parasysht se kodi dhe destinimi eshte : banim/banim i përhershëm , dhe eshte kompatibil me kërkesën tuaj por se me nje nivel tjetër te planifikimit (hzhk) do te mund te përcaktohet intensiteti dhe vlerat tjera qe përcaktojnë kategorizimin e zonave te destinuara per banim.
3	Sabit Berjani	26.08.2025	Kërkojmë nga Drejtoria e Urbanizmit që parcelën me numër 264-0 ta përfshijë në zonë ndërtimore e poashtu së bashku me parcelat 265 dhe 266; 420 të ndrrohet destinimi nga banim në biznes. Gjithashtu parcelat në Miradi të Epërme me nr. parcelës 444-0; 93-0; 104-0 dhe 128-48 të përfshihen në zona ndërtimi për arsye se afër këtyre parcelave ka ndërtime të shtëpive dhe biznese, prandaj kërkoj që edhe këto parcela të përfshihen në hartën e re zonale sikurse zonat që janë afër tyre.	Kërkesa lidhur me parcelat 264-0, 265, 266 420 nuk mund të aprovohet pasi destinimi i tokës në këtë zonë është përcaktuar për banim, në përputhje me strukturën ekzistuese urbane dhe strategjinë zhvillimore të PZhK-së.Poashtu edhe me hartën zonale komunale eshte zone e destinuar per banim individual(banim i ulet). Ndryshimi i destinimit në biznes dhe zgjerimi i zonës ndërtimore (ku përfshihen parcelat 444-0, 93-0, 104-0, 128-48) do të krijonte shpërndarje jo të kontrolluar urbane (urban sprawl) dhe do të binte ndesh me kufijtë e zonimit të përcaktuar në Hartën Zonale Komunale.

4	Hasim Rashica	28.08.2025	Lidhur me diskutimin publik për PZhK Fushë Kosovë 2025-2033, kërkojmë që te harta e shfrytëzimit të planifikuar të tokës të rregullohet destinimi për parcelën me nr. 00040-0 në ZK. Pomezotin. Kjo parcelë të destinohet për banim/banim tjetër – jo i përhershëm por që ka mundësi të planifikohet si zonë ndërtimi. Ky lokacion ka të gjitha parakushtet dhe infrastrukturën e nevojshme që të shfrytëzohet si i tillë – banim jo i përhershëm.	Ju informojmë se qysh ne fazat e para te diskutimeve publike ka patur nje interesim te madh per kete zone ne kuptimin qe te lejohet nje zhvillim qe do te perkrahte ndërtimin e villave malore, kjo per arsye se edhe tani ne kete faze veq se ka filluar te kete nje aktivitet ndërtimor por qe me planet hapësinore aktualisht nuk perkrahet. Grupi punues ka marre parasysh këto kërkesa dhe se ne pzhk edhe kjo parcele bene pjese ne bllokun i cili eshte destinuar si banim/banim tjetër qe nënkupton se me planin hapësinor te nivelit me detal do te përcaktohen kriteret dhe aktivitetet e lejuara ndertimore.
5	Ramadan Rashica Muhamet Rashica Gani Rashica	28.08.2025	Kërkojmë që tek parcela me nr. 00040-0 në ZK. Pomezotin, të destinohet për planifikim banim / banim tjetër. Kjo të destinohet për shfrytëzim të lejimit të ndërtimit për objekte të vogla por me karakter të banimit jo të përhershëm. Kërkojmë që te harta e shfrytëzimit të planifikuar të tokës të bëhet ky rregullim.	Ju informojmë se qysh ne fazat e para te diskutimeve eshte vërejtur nje interesim i konsiderueshëm per kete zone, kryesisht ne drejtim te krijimit te mundësisë per zhvillime qe do te përfshinin ndërtimin e vilave malore kjo per arsye te afërsisë me parkun rekreativ “Pishat e Sllatines se vogël”. Grupi punues ka shqyrtuar këto kërkesa duke marre parasysh arsyet dhe poashtu gjendjen faktike ne teren dhe se kjo zone eshte destinuar per banim/banim me tipologji tjetër qe nënkupton se me planet hapësinore me detale do te përcaktohen kriteret ndertimore dhe aktivitetet ndërtimore te lejuara .
6	Arif Shabani	28.08.2025	Këkojë që parcela me nr. 00847-1, ZK. Sllatinë e Madhe të destinohet në zonë industriale sikurse parcelat tjera afër hekurudhës që janë destinuar në zonë industriale, parcela ka dalje në rrugën për Magure dhe ka qasje në hekurudhë.	Kërkesa nuk mund të aprovohet pasi zona përkatëse nuk është e përcaktuar si zonë industriale në PZhK. Destinimi industrial është i kufizuar në zonat specifike të identifikuar në dokumentin planifikues (zona industriale në Sllatinë e Madhe dhe Harilaq). Përfshirja e parcelave shtesë jashtë kufijve të këtyre zonave do të krijonte fragmentim hapësinor dhe vështirësi në menaxhimin e infrastrukturës industriale. Poashtu kjo zone nuk eshte e pajisur me infrastrukture dhe se nuk ka qasje ne asnjë rruge zyrtare.

7	Hasan Osmani	01.09.2025	Kërkoj nga Drejtoria e Planifikimit Urban që zona kadastrale në Pomozotin, konkretisht parcela 00361-5 dhe parcelat tjera përreth të kenë mundësinë e ndërtimit të ulët dhe të përkohshëm. Unë dhe pronarët e kësaj lagje me numra të parcelave 00361-1, 2, 3,.....30. kërkojmë që të planifikohet dhe të na lejohet me PZhK 2025-2033 shfrytëzimi i kësaj pjese të tokës për banim të përkohshëm.	Ju informojmë se qysh ne fazat e para te diskutimeve eshte vërejtur nje interesim i konsiderueshëm per kete zone, kryesisht ne drejtim te krijimit te mundësisë per zhvillime qe do te përfshinin ndërtimin e vilave malore kjo per arsye te afërsisë me parkun rekreativ “Pishat e Sllatinës së vogël”. Grupi punues ka shqyrtuar këto kërkesa duke marre parasysh arsyet dhe poashtu gjendjen faktike ne teren dhe se kjo zone eshte destinuar per banim/banim me tipologji tjetër qe nënkupton se me planet hapesinore me detale do te përcaktohen kriteret ndertimore dhe aktivitetet ndërtimore te lejuara . (Edhe këto parcela bëjnë pjese ne bllokun-zonen
8	Muhamet Gërguri	02.09.2025	Kërkoj që parcela 451-0 dhe 426-5 ZK. Sllatinë e Vogël të trajtohet në zonë industriale sikur parcelat në fqinjësi dhe parcelat 430-1, 430-2, 430-4, 288-1, 288-2 ZK. Sllatinë e Vogël të kenë destinim të përzier Banim – Afarizëm sikur parcelat në fqinjësi.	Kerkesa juaj eshte aprovuar per arsye se edhe ne harmoni me skenarin zhvillimor te përcaktuar nga komuna e fushe kosoves dhe se këto parcela bëjnë pjese ne shiritin e zhvillimit ekonomik. Kete kerkese grupi punues e ka trajtuar edhe me herët ne (aplikimin tuaj paraprak) dhe se gjate periudhës se shqyrtimit publik keni mundur ti shihni zhvillimet e planifikuara per këto parcela.
9	Mërgim Prishtina Trepsharm	04.09.2025	Kërkojmë nga Kuvendi Komunal i Fushë Kosovës e cila në Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Fushë Kosovës 2025 – 2033, parcelën me nr. 00665-6 në Sllatinë të Madhe nga destinimi i cili sipas Planit Zhvillimor Komunal është paraparë të jetë Prodhim Parsor/Pylltari i bazuar në mbules të vazhdueshme. Kërkojmë për arsye të zgjerimit të kapaciteteve prodhuese, objekteve përcjellëse me investitor gjerman, kërkojmë të ndryshohet destinimi në: Prodhim tretësor/ Industri e prodhimeve të lehta / prodhim i pijeve, ushqimeve dhe produkteve të duhanit.	Kerkesa juaj eshte ne harmoni me objektivat zhvillimore dhe vizionin per zhvillim te Komunës se Fushe Kosoves eshte aprovuar gjate shqyrtimit te kërkesave ne fazën e shqyrtimit publik 30 ditor dhe se zona e tashme e destinuar zi zone industriale eshte zgjeruar duke perfshire kështu edhe parcelën 665-6 brenda këtij zgjerimi.
10	AL Trade Center Sh.P.K	04.09.2025	Kërkojë që parcelat me nr. 02022-0, 02017-4, 02017-5, 02018-2, 02011-1, 02012-1, 02007-4, 02008-1, 02003-2, 01641-5, 01641-4, 01648-0 ZK. Fushë Kosovë të destinohen si zonë Komerciale ose zonë për shfrytëzim të përzier duke krijuar në këtë formë zhvillim të vazhdueshëm me zonat përreth sepse konsiderojmë se në këtë formë	Kerkesa juaj eshte ne harmoni me objektivat zhvillimore dhe vizionin per zhvillim te Komunës se Fushe Kosoves eshte aprovuar gjate shqyrtimit te kërkesave ne fazën e shqyrtimit publik 30 ditor dhe se zona ku bëjnë pjese këto parcela eshte tashme e destinuar si zone komerciale, kështu duke iu

			përfashtohemi pa të drejtë nga zhvillimet e mundshme për periudhën 10 vjeqare. Vlerësojmë që ka mjaftueshëm argumente që kjo zonë të mos mbetet zonë bujqësore andaj mbesim me shpresë se kërkesa jonë të merret parasysh.	bashkangjitur bllokut ekzistues me po të njëjtin destinim.
11	Përfaqësues i Fshatit Sllatinë	03.09.2025	Kërkojë nga Komuna që parcela 01065-0 të jetë zonë e mbrojtur pasi në të kemi qëndruar gjatë luftës dhe është varri i mesuesit Kadri.	Kërkesa nuk mund të aprovohet pasi që nuk kemi ndonjë dokument zyrtar që definon zonat e mbrojtura në të cilin bene pjese edhe kjo parcele.
12	Agim Shishani	04.09.2025	Kërkojë që parcela 00848-0 ZK. Sllatinë e madhe të shëndrrohet në zonë industriale se jemi afër hekurudhës, si parcelat që janë bërë.	Kjo kërkesë nuk mund të aprovohet për arsye se : Në këtë zonë mungojnë parakushtet për infrastrukturë dhe shërbime publike, dhe ndryshimi i destinimit do të krijonte precedent për zhvillim të pakontrolluar në zonat rurale.
13	Hashim Shabani	04.09.2025	Kërkojë nga K.K. Fushë Kosovë që parcelat 00847-1 zona kadastrale Sllatinë e Madhe të shëndrrohet në zonë industriale	Kjo kërkesë nuk mund të aprovohet për arsye se : Në këtë zonë mungojnë parakushtet për infrastrukturë dhe shërbime publike, dhe ndryshimi i destinimit do të krijonte precedent për zhvillim të pakontrolluar në zonat rurale.
14	Ekrem Shabani	04.09.2025	Në parcelën 14-1 ZK. Sllatinë e Madhe ka pemishte, është çeshmja e katunit andaj kërkojmë që të jetë siq ka qenë zonë bujqësore.	Ne kornizën zhvillimore dhe në skenarin e përzgjedhur për zhvillimin e komunës së fushe kosoves , një skenar policentrik që garanton zhvillim në disa zona, jo veten e zonës urbane të Fushe Kosoves, është propozuar qysh në fazat fillestare që edhe kjo zonë të ketë mundësinë për zhvillim dhe se me tutje varet nga pronaret e parcelave sikurse kjo se a dëshiron të jete pjese e zhvillimit apo jo. Përndryshe zona kadastrale Sllatinë e Madhe bene pjese në zonat në të cilat janë bërë zgjerime në ndërtim dhe kjo zonë është destinuar banim i përhershëm (zonë banimi).
15	Ekrem Shabani	04.09.2025	Kërkojmë që parcela 00265-0, 00267-0 dhe 00226-8 të mos kalojnë në zonë banimi se janë prona të fshatit Sllatinë e Madhe. Parcela 00226-8 është pronë e Shabanovitëve mos të bëhen matematika me prona. Që 25 vjet as një shtëpi nuk është ndërtu në këto pjesë, mos boni llogari për interesa të juaj.	Ju informoj se këto parcela në departamentin e pronës në Komunë e Fushe Kosoves në baze të certifikatave të pronësisë janë prone shoqërore : P.sh Kombinati i drurit -Ferizaj. Sa i përket përfshirjes në bllokun e ndërtimit me destinim banim/banim i përhershëm konsiderojmë se kjo vetëm se i kontribuon zhvillimit homogjen dhe zgjerimit të zonës ndërtimore të fshatit Sllatinë

				e Madhe, por qe nuk do te thotë se me patjetër do te ndërtohet ne këto parcela, duke pas parasysh edhe parimin e sipërfaqeve te gjelberta brenda blloqeve te ndërtimit.
16	Fatlum Vërbovci	04.09.2025	Kërkojmë që sipas Planit Zhvillimor Komunal që është në diskutim publik të Planifikohet në zonën katastrale Pomozotin parcela me numer 00042-22 të diskutohet për banim tjetër e cila do të ketë banim të përkohshëm. Infrastruktura është e kompletuar për këtë zonë (rrugë, energji elektrike, ujësjellës dhe kanalizim) dhe ka kushte të mjetueshme për ndërtim me karakter të përkohshëm.	Ju informojmë se qysh ne fazat e para te diskutimeve publike ka patur nje interesim te madh per kete zone ne kuptimin qe te lejohet nje zhvillim qe do te perkrahte ndërtimin e villave malore, kjo per arsye se edhe tasni ne kete faze veq se ka filluar te kete nje aktivitet ndërtimor por qe me planet hapesinore aktualisht nuk perkrahet. Grupi punues ka marre parasysh këto kërkesa dhe se ne pzhk edhe kjo parcele bene pjese ne bllokun i cili eshte destinuar si banim/banim tjetër qe nënkupton se me planin hapësinor te nivelit me detal do te përcaktohen kriteret dhe aktivitetet e lejuara ndertimore.
17	Besnik Jashanica	04.09.2025	Kërkojë që parcela 00971-5 ZK. Sllatinë të bëhet Zonë Industriale nga toka bujqësore.	Kjo kërkesë nuk mund të aprovohet për arsye se : Në këtë zonë mungojnë parakushtet për infrastrukturë dhe shërbime publike, dhe ndryshimi i destinimit do të krijonte precedent për zhvillim të pakontrolluar në zonat rurale.

9. NDRYSHIMET E BËRA NË PROJEKT PLANIN ZHVILLIMOR KOMUNAL TË FUSHË KOSOVËS 2025 - 2033

Gjatë procesit të shqyrtimit publik të Projekt Planit Zhvillimor Komunal të Fushë Kosovës 2025–2033, Komuna ka pranuar një numër kërkesash (17 kërkesa) nga qytetarë dhe palë të interesuara, të cilat kryesisht kishin të bëjnë me ndryshimin e destinimit të tokës – nga bujqësore në komerciale, nga banim në biznes, nga bujqësore në industriale, si dhe kërkesa për përfshirje të parcelave të caktuara në zona ndërtimore apo në planifikim për banim të përhershëm apo jo të përhershëm.

Pas shqyrtimit të detajuar teknik dhe profesional, u konstatua se disa nga kërkesat e adresuara nuk përputhen me vizionin zhvillimor të komunës, parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe me udhëzimet e politikave hapësinore të nivelit qendror. Po ashtu, disa nga kërkesat bien ndesh me kriteret e përcaktuara në Hartën Zonale Komunale dhe me orientimet e dokumenteve të planifikimit hapësinor që tashmë janë miratuar dhe një numër i vogël i tyre është aprovuar.

Për këto arsye, të gjitha komentet e pranuar gjatë shqyrtimit publik janë trajtuar dhe kanë marrë përgjigje, disa prej tyre pasi nuk kanë bazë profesionale dhe ligjore që ato të përfshihen në Projekt Planin Zhvillimor Komunal të Fushë Kosovës nuk kanë pësuar ndryshim të zhvillimeve të planifikuara ndërsa një pjesë e tyre që kanë patur një argumentim dhe baze ligjore e poashtu kanë siguruar vazhdimësi të zhvillimeve të paracaktuara janë marrë parasysh dhe janë inkorporuar në Hartën e zhvillimeve të planifikuara të PZHK-së.

Si rezultat, Projekt Plan Zhvillimor Komunal i Fushë Kosovës 2025 – 2033, i dorëzuar më herët në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës konsiderohet I PANDRYSHUAR.

9. KONKLUZIONE

Procesi i shqyrtimit publik të Projekt Planit Zhvillimor Komunal të Fushë Kosovës 2025–2033 u zhvillua në përputhje me kërkesat ligjore dhe udhëzimet administrative të planifikimit hapësinor. Komuna e Fushë Kosovës u angazhua që ky proces të jetë gjithëpërfshirës, duke ofruar transparencë dhe mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët dhe palët e interesuara për të dhënë komentet dhe sugjerimet e tyre.

Gjatë kësaj faze, u pranuan disa komente dhe kërkesa nga qytetarët, të cilat u shqyrtuan me kujdes nga grupi punues profesional. Megjithatë, pas analizës së argumentuar teknike dhe profesionale, u konstatua se disa nga kërkesat e adresuara nuk ishin në përputhje me vizionin zhvillimor, objektivat strategjike dhe parimet e përcaktuara në Draft-PZHK. Për këtë arsye, kërkesat nuk janë përfshirë në dokumentin përfundimtar. Ndërsa ato që u morën parasysh përbejnë disa ndryshime kozmetike të cilat nuk e ndryshojnë qasjen zhvillimore por mund të themi se veten sa e plotësojnë dokumentin dhe shmangin gabimet që kanë mund të behen gjatë fazave të hartimit.

Procesi i shqyrtimit publik ka shërbyer për të siguruar pjesëmarrjen aktive të komunitetit dhe ka kontribuar në forcimin e transparencës institucionale dhe konsiderohet i gatshëm për fazat e mëtejme të miratimit.

10. PËRFUNDIM

Drejtoria e Planifikimit Urban e Komunës së Fushë Kosovës, pas përfundimit të procesit të shqyrtimit publik të Projekt Planit Zhvillimor Komunal 2025–2033, njofton se të gjitha procedurat janë zhvilluar në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor, UA Nr.11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe UA Nr.05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor si dhe aktet tjera nënligjore përkatëse.

Procesi i shqyrtimit publik është zhvilluar duke respektuar parimin e transparencës dhe përfshirjes së palëve të interesit, ndërsa të gjitha komentet dhe vërejtjet e pranuar janë shqyrtuar dhe trajtuar me përgjegjësi profesionale.

Në bazë të nenit 18 të Ligjit Nr. 04/L-174, i cili përcakton se pas përfundimit të shqyrtimit publik Raporti i shqyrtimit publik duhet të dorëzohet në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor, ky dokument i përcillet zyrtarisht Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për shqyrtim të mëtejshëm dhe procedim drejt miratimit të Planit Zhvillimor Komunal 2025–2033 të Fushë Kosovës.

Në emër të Drejtorisë së Planifikimit Urban, ju dorëzojmë këtë raport si hap të radhës ligjor dhe procedural, në funksion të finalizimit të dokumentit zhvillimor strategjik të komunës.

Me respekt,

Drejtoria për Planifikim Urban

Drejtor i Drejtorisë: **Msc. Ark. Parayll Zogjani**